

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDERVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRIË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#13

Ministri merr pjesë në ceremoninë e 20 vjetorit të Eksodit të Luftës së Kosovës



Ministri Majko merr pjesë në ceremoninë e 20 vjetorit të Eksodit të Luftës së Kosovës. Në këtë përvjetor jubilar anëtarët e "Batalionit të Atlantikut" dhe qytetarë të tjerë kanë përshkuar të njëjtin rrugëtim si dy dekada më parë, kohë kur luftonin për lirinë e Kosovës.

Ministri i Majko në mënyrë simbolike i ka pritur sërish pjesëtarët e Batalionit, në pikën kufitare të Kukësit, ashtu si dy dekada më parë, por tashmë në një Kosovë të lirë dhe të pavarur.

"Batalioni i Atlantikut" u formua 20 vite më parë nga shqiptaro-amerikanë të cilët vendosën të ktheheshin në Kosovë për të luftuar për lirinë e vendit. Sot ata ende vazhdojnë aktivitetin e tyre patriotik nëpërmjet shoqatës "Atlantiku".

Në ceremoninë e organizuar në Kukës, për 20 vjetorin Eksodit të Luftës së Kosovës



Vizita në SHBA, ministri takohet me Drejtorin Ekzekutiv të Bordit të Grupit të Bankës Botërore

Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi një takim me z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Grupit të Bankës Botërore në Washington DC, i cili përfaqëson Italinë, Shqipërinë, Greqinë dhe disa vende të tjera.

Në këtë takim u diskutua mundësia e thellimit të mbështetjes me projekte të Diasporës shqiptare, si një bashkëpunim midis ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë në kuadrin e Strategjisë së Bankës Botërore për vendin.

Synimi i këtij projekti do të ishte kanalizimi i remitancave në një mënyrë të qëndrueshme për zhvillimin e vendit. U diskutua edhe mundësia e organizimit të një takimi vjetor rajonal për remitancat.

Gjatë takimit ministri njohu përfaqësuesit e Bankës Botërore me politikën shtetërore shqiptare për Diasporën si dhe ecurinë e Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

<https://diaspora.gov.al/ne-shba-ministri-takohet-me-drejtorin-ekzekutiv-te-bordit-te-grupit-te-bankes-boterores/>



Ministri zhvilloi takim me Shefin e Misionit të FMN për Shqipërinë, z. Jan Kees Martij

Gjatë vizitës në SHBA, ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi takim me Shefin e Misionit të FMN për Shqipërinë, z. Jan Kees Martij.

Gjatë këtij bashkëbisedimi, u fol për rëndësinë që ka ky institucion për qeverinë shqiptare dhe z. Majko e njohu z. Martij me politikën shtetërore të hartuara për Diasporën.


Me interes gjatë kësaj bisede ishte fusha e arsimit dhe lehtësimi i procedurave për rikthimin e shqiptarëve në Atdhe, ku ministri i Shtetit për Diasporën u shpreh:

"Në ligjin e ri për qeverisjen lokale, i cili pritet të kalojë në parlament, janë duke u krijuar Zyrat e qeverisjes vendore për shërbimin e Diasporës dhe emigracionit."

Gjithashtu, u bisedua për bashkëpunime në fushën e Diasporës në të ardhmen.

<https://diaspora.gov.al/ministri-zhvilloi-takim-me-shefin-e-misionit-te-fmn-per-shqiperine-z-jan-kees-martij/>

Në SHBA, ministri merr pjesë në konferencën ndërkombëtare për fuqizimin global të mbajtur në Harvard



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko mori pjesë në takimin e 11-të të konferencës ndërkombëtare për fuqizimin global "Global Empowerment Meeting" (GEM19), e cila organizohet çdo vit nga "Harvard Kennedy School" në SHBA. Në këtë konferencë dy ditore, ishin të pranishëm personalitete të larta nga vende të ndryshme të botës. Këtë vit, diskutimi i konferencës u përqendrua tek problematikat që hasen në botë, midis zhvillimit politik të një vendi dhe zhvillimit ekonomik.



20-vjetori i krijimit të "Batalionit të Atlantikut", ministri i Shtetit për Diasporën priti anëtarët e delegacionit të tij.

Me rastin e 20-vjetorit të krijimit të "Batalionit të Atlantikut", ministri i Shtetit për Diasporën u takua me anëtarët e delegacionit të tij.

Në fjalën e tij ministri Majko u shpreh se "Rasti i "Batalionit të Atlantikut" është një rast shumë i veçantë në histori, i cili tregon rëndësinë dhe vlerën e të qenurit shqiptar në Diasporë".

Gjatë bashkëbisedimit, ministri Majko vlerësoi kontributin e pjesëtarëve të "Batalionit të Atlantikut", ai tha se ata janë një shembull i veçantë, për të cilin mund të shkruhet vetëm në libra. "Ju, të gjithë pjesëtarët e Batalionit të Atlantikut" na keni nderuar, falë jush sot kemi realitet të ri, të cilin e shohim nga distanca e 20 viteve.

Pas përfundimit të luftës, si vazhdimësi e Batalionit të Atlantikut për ruajtjen e çështjeve kombëtare u themelua Shoqata "Atlantiku". Kryetari i kësaj shoqate, z. Gani Shehu në këtë përvjetor të rëndësishëm theksoi edhe një herë guximin e një numri të madh të të rinjve shqiptaro-amerikanë, të cilët lanë jetën e tyre në SHBA, për t'iu bashkuar luftës çlirimtare të popullit të Kosovës, nën emrin "Batalioni i Atlantikut".

<https://diaspora.gov.al/20-vjetori-i-krijimit-te-batalionit-te-atlantikut-ministri-i-shtetit-per-diasporen-priti-anetaret-e-delegacionit-te-tij/>



Vizita në Bibliotekën e Kongresit Amerikan

Në ditën e dytë të vizitës në SHBA, ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko vizitoi Bibliotekën e Kongresit Amerikan, në të cilën ruhen vepra të autorëve shqiptar si Fan Noli dhe Faik Konica.

Ministri u takua me përgjegjësin e seksionit Evropian z. Grant Harris. Njohës i mirë i botimeve në gjuhën shqipe, ai njohu ministrin me disa nga botimet e rralla në gjuhën shqipe që ndodhen në këtë bibliotekë, si gazeta "Taraboshi" botuar në SHBA në vitet 1913, etj.

Ministri dhe z. Harris biseduan për mundësinë e bashkëpunimit dhe pasurimin e kësaj biblioteke me botime me fokus Diasporën shqiptare, të cilat do të jenë në dispozicion të komunitetit shqiptar.

Si hap të parë të këtij bashkëpunimi, z. Harris iu dhuruan librat Politikat Shtetërore për Diasporën dhe Diaspora Shqiptare.

<https://diaspora.gov.al/ministri-vizite-ne-biblioteken-e-kongresit-amerikan/>

Në takimin e organizuar nga "The Open Gov Hub" dhe "Open Government Partnership"

Ministri Majko mori pjesë në takimin e organizuar nga "The Open Gov Hub" dhe "Open Government Partnership" në Washington, SHBA me temë diskutimi qeverisjen transparente.

Gjatë fjalës së tij ministri u ndal te reformat konkrete që janë aplikuar në politikën shtetërore shqiptare për Diasporën.

Gjithashtu i njohu të pranishmit me të gjitha format e publikimit dhe nivelin e transparencës të institucioneve në varësi të tij: Buletini tre mujor, i cili paraqet ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, "Periodiku" i Fondit të Zhvillimit të Diasporës, Raportet vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, si dhe publikimin informativ të përvjetshëm "Newsletter e Diasporës".

Ministri i Shtetit për Diasporën u shpreh se transparenca e informacionit e mbështetur në bazën e llogaridhënies, pjesëmarrjes qytetare sjellë një qeverisje më të përgjegjshme.

Gjatë këtij takimi Organizata për "Partneritetit të Qeverisë së Hapur" (OGP) prezantoi nismën e saj në Shqipëri, hapjen e zyrës rajonale në Tiranë.

<https://diaspora.gov.al/ministri-mori-pjes-ne-takimin-e-organizuar-nga-the-open-gov-hub-dhe-open-government-partnership/>



Takimi i radhës me grupin ndërinstitucional të punës për zbatimin e urdhërit 181/2018 të Kryeministrit për të bërë funksional pavijonin e Diasporës, në Muzeun Kombëtar. Gjatë këtij takimi u bë një përmbledhje e gjithë punës ku u prezantuan edhe disa nga konkluzionet e arritura nga ky grup.